



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 659/23

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Mejreme Memaj, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Argjira Asllani, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatore e panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari L. O., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPKR-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000€, me aktgjykimin PML.nr.122/2023 të datës 08.08.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117 dhe 118 par. 4 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 12, 13, 14, 18, 22, 25 par.1 pika 1.2 dhe nenin 33 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me 07.12.2023, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për lirimin me kusht e të dënuarit L. O. nga i ati I. dhe e ëma H., e gjinisë K., i lindur me datë ..., në fshatin M., Komuna B., me vendbanim në Gj., rr. "...", nr. .., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. Kërkesa për lirimin me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 3 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.417/22, i datës 31.10.2022, L. O. është shpall fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPKR-së, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.724/22, i datës 13.02.2023, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite dhe dënim me gjobë në

shumë prej 1000€. Ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë me aktgjykimin PML.nr.122/2023, të datës 08.08.2023, ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, sa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale, ashtu që konstaton se veprimet e të dënuarit, kualifikohen si veprë penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPKR-së. Po ashtu, Gjykata Supreme i ndryshon aktgjykimet edhe sa i përket dënimit me gjobë, ku të dënuarit i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 1000€.

Me datë 30.10.2023, i dënuari ka parashtruar kërkesën për lirim me kusht përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg, me arsyetimin se gjatë vuajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirin e tij me kusht.

Paneli për lirim me kusht në seancën e mbajtur me datën 07.12.2023 pasi e shqyrtoi kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se:

Kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar.

Nga shkresat e çështjes, dosja e të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPKR-së.

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirin normal e ka me datë 20.12.2024 dhe nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rezulton se gjer më tani i ka vuajtur 1 vit, 11 muaj, 17 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 1 vit, 13 ditë. Në raportet e tjerë të përpiluara nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese rezulton se i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit ka treguar sjellje të mirë dhe merr pjesë në aktivitete rekreative – sportive. Sa i përket qëndrimit ndaj veprës penale, i dënuari nuk e pranon duke deklaruar se substancat narkotikë kanë qenë për konsumim personal dhe jo për shitje. Tutje në raporte lidhur me procesin e risocializimit është konstatuar se ende nuk është arritur risocializimi i plotë.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, Paneli ka vlerësuar kushtet për lirim me kusht, të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, duke përfshirë kriteret e parashikuara në Rregulloren 01/39 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për lirim me kusht. Kriteret përfshijnë: peshën e krimit, historinë e kaluar kriminale, përshkrimin e personit të dënuar për krimin, qëndrimin ndaj viktimës, sjelljen gjatë burgimit, gjendjen psikiatrike dhe psikologjike, gjendjen fizike, historinë sociale, planet pas lirit, pranimin e kontrollit dhe ndihmën nga Shërbimi Sprovues, ekzistencën e një rreziku të përgjithshëm për publikun, dhe perspektivën e një personi të dënuar me origjinë të huaj për të kthyer në shtëpi.

Paneli, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerësimit të gjitha kushteve dhe kriterëve si më lartë, konstatoi se procesi i risocializimit ende nuk është i plotë, duke marr parasysh peshën e veprës penale të

kryera nga i dënuari, ngase pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes se veprave tilla apo të ngjashme penale dhe historinë e kaluar penale, andaj bazuar në këto konstatime, Paneli vlerëson se qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal, sipas dispozitave të nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është arritur, andaj kërkesa e personit të dënuar është refuzuar për një periudhë kohore prej 3 muajve dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Nga sa u tha më lartë, në zbatim të nenit 25 pika 1.2 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT
PLK. D. nr. 659/23, datë 07.12.2023**

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Mejreme Memaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.